



UNMIK/REG/2005/33
5 korrik 2005

RREGULLORE NR. 2005/33

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR.2002/18
MBI THEMELIMIN E ZYRËS SË REVIZORIT TË PËRGJITHSHËM TË
KOSOVËS DHE ZYRËS SË REVIZIONIT TË KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/18 mbi themelimin e zyrës së revizorit të përgjithshëm të Kosovës dhe të zyrës së revizionit të Kosovës, më 2 tetor 2002,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003 mbi shpalljen e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës,

Me qëllim të harmonizimit të kërkesave për publikimin e raporteve të revizorit të përgjithshëm sipas ligjit në fuqi dhe për ta përmirësuar transparencën dhe përgjegjësinë e organizatave buxhetore të cilat i nënshtrohen kontrollit nga zyra e revizionit,

Me anë të kësaj shpall ndryshimet në vijim të neneve 3 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/18:

Neni 1
Ndryshimet

Prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,

A. Neni 3.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/18 ndryshohet si në vijim:

- (i) Nënparagrafi (b) fshihet dhe nënparagrafi pasues rinumërohet në përputhje me këtë;
- (ii) Në nënparagrafin (b) të rinumëruar fshihen fjalët “Me kusht që më parë të sigurohet nga PSSP-ja autorizimi në formë të shkruar”;
- (iii) Në nënparagrafin (c) fshihen fjalët “njëzet e tetë (28)” dhe zëvendësohen me fjalët “katërmëdhjetë”;
- (iv) Në nënparagrafin (d) fshihen fjalët “Në varësi të udhëzimit me shkrim të përmendur në nenin 3.3 (b)” dhe në fund të nënparagrafit shtohet fjalia në vijim: “Kopjet e raportit të revizorit të përgjithshëm vihen në dispozicion të publikut.”
- B. Në nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/18 shtohet nënparagrafi (e) i formuluar si në vijim:
- “(e) Brenda 30 ditëve pas publikimit të raportit përkatës të revizionit, institucioni ose subjekti i kontrolluar në pajtim me nenin 3.2 ia dorëzon revizorit të përgjithshëm një raport në të cilin tregohet se si mendon institucioni ose subjekti t’i zbatojë rekomandimet e dhëna në raportin e revizionit”.
- C. Neni 3.4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/18 ndryshohet duke e fshirë fjalën “rregullues” dhe duke e zëvendësuar atë me shprehjen “i rregullt”.
- D. Fjalët “nenet 3.3 ose 4.9” në nenet 4.10.1, 4.10.2 dhe 4.20.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/18 zëvendësohen me “neni 4.9”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 5 korrik 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm